

HEXHEM



Republika e Kosovës  
Republika Kosova  
Republic of Kosovo

REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA  
KOMUNA E VITISË - OPŠTINA VITINA

13-01-2021

09-050/01-12	viere viednos
--------------	------------------



Komuna e Vitisë  
Opština Vitina  
Municipality of Vitina

## Drejtoria e shërbimeve Publike dhe Emergjencë

### PLANI I PUNËS 2021

JANAR - DHJETOR 2021

## **PLANI I PUNËS I DREJTORISË SË SHËRBIMEVE PUBLIKE DHE EMERGJENCË**

Në bazë të nenit 20 dhe 21 të vendimit për organizimin , kompetencat dhe përgjegjësit e organeve komunale të komunës së Vitisë me nr.02-013/778 të dt.07.06.2011, Drejtori i drejtorisë për shërbime publike dhe emërgjencë prezanton planin e punës janar – dhjetor 2021.

Si bazë ligjore për përpilimin e programit të punës, jemi shërbyer me këto akte normative siq vijon :

- Ligjet në fuqi dhe aktet tjera nënligjore
- Statuti i Komunës së Vitisë
- Vendimi për organizimin, kompetencat dhe përgjegjësit e organeve Komunale
- Plani i gadishmërisë emergjente për komunën e Vitisë
- Në planin e punës janë përfshirë punët dhe detyrat e planifikuara për periudhën janar – dhjetor 2021, sipas bartësve të punës dhe afatit kohor të realizimit të tyre.

Drejtorja e shërbimeve publike dhe emërgjencë ndahet në dy sektorë :

1. Sektori për Shërbime Publike
2. Sektori për Emergjencë

### **1. SEKTORI I SHËRBIMEVE PUBLIKE**

Sektori i shërbimeve publike ofron shërbimet publike dhe infrastrukturën, duke përfshirë edhe aspektin financiar :

- Organizimin e punëve në Sektorin e shërbimeve publike;
- Bëhet kontrollimi dhe percjellja e buxhetit për D.SH.P dhe E;
- Planifikimi i shpenzimit të buxhetit të planifikuar për 2021;
- Planifikimi i të gjitha të hyrave për vitin 2021-2022-2023;
- Planifikimi i buxhetit për mallëra dhe shërbime për vitin 2021,2022,2023;
- Planifikimi i buxhetit për shpenzime Komunale për vitin 2021-2022-2023;
- Realizimi i të hyrave vetanake të planifikuara për vitin 2021;
- Zbatimi i Rregullores Komunale për taksa, ngarkesa dhe gjoba;
- Implementimin e Vendimeve të ndyshme ;
- Furnizimin me ujë ( ujësjellës) dhe Mirëmbajtja e kanalizimit;
- Menagjimi i mbeturinave;
- Hapsirat publike;
- Trafiku dhe Transporti urban dhe Urbano- Periferik;
- Rugët lokale;
- Hartimi i rregullorës për Shërbime Publike Komunale;
- Mirëmbajtjen dhe pastrimin e objekteve Komunale;
- Mirëmbajtja e aparateve kundërzjarrit.
- Mirembajtja e ndriqimit publik

- Dezifektimin, Deratizimin dhe Dezinsektimin e objekteve Komunale, Arsimore , shendetesore dhe hapsirat publike në Komunën e Vitisë.
- Do te bëhet menagjimi i kontratave i dhënjës në shfrytëzim të pronës Komunale.

### **1.1Furnizimi me ujë( ujësjellës) dhe Mirëmbajtja e kanalizimit**

- Bashkëpunon me kompaninë regjionale, në ofrimin e shërbimeve publike-lokale , Hidromorava, njësi në Viti, duke përfshir furnizimin me ujë , mirëmbajtjen e rrjetit të ujsjellësit dhe rrjetin e kanalizimit;
- Në bashkëpunim me kompaninë në ofrimin e shërbimeve publike-lokale , Hidromorava njësi një Viti, bëjmë sigurimin e ujit të picshëm nëpër pjesët të cilat nuk kanë mundësi të sigurojnë ujin e pijshëm në raste emergjente;
- Regullimi i shërbimeve me ujë bëhet sipas marrveshjes mbi shërbimet e caktuara me ligjin e qeverisë së Kosovës.
- Mirëmbajtja e kanalizimit dhe unjësjellsve behet nga kompania e perzgjedhur nga komuna në ato vendbanime ku nuk menagjohet nga kompania regjionale Hidromorava, Viti.

### **1.2-Menaxhimi i mbeturinave**

Bazuar në Ligjin mbi mbeturinat , drejtoria obligohet :

- Mbedhjen, transportin në deponinë e mbeturinave përmesë kompanis Publike-Private “Eco- Higjiena”;
- Aprovon orarin dhe kohen e propozuar për bartjen e mbeturinave ;
- Zbaton Planin për Menaxhimin e Mbeturinave dhe
- Rregulloren për Menaxhimin e Mbeturinave .

### **1.3 Hapsirat Publike**

- Do të punojmë me qytetarët, policinë dhe me autoritetet tjera për të implementuar projekte dhe kontrole, me anë të të cilave ofrohet siguri për fëmijët në vendet publike;
- Bëjmë mirëmbajtjen e Hapsirave Publike;
- Bëjmë lëshimin e lejeve për shfrytëzimin e hapsirave publike, para lokaleve, për shitjen e librave, lodrave për fëmijë dhe vendosjen e objekteve lëvizës.;
- Mirëmbajmë ndriqimin publikë.;
- Dekorimin e qytetit për festat e fundvitit.
- Mirmbajtja dhe parstrimi i trotuareve;

- Do të bëjmë mirmbajtjen e të gjitha shesheve që i përkasin komunës;
- Mirëmbajtjen e varrezave të qytetit, dëshmoreve dhe momorialeve dëshmoreve.
- Mirëmbajtjen e Objekteve Komunale (Administrata , Shëndetësia dhe Arsimi)

#### **1.4 Trafiku dhe Transporti urban, urbano-periferik dhe ndërurban**

- Do të bëjmë mbikqyrjen e transportit lokal, brenda territorit të komunës në pajtim me ligjin e transportit rrugorë dhe Rregulloren për Organizimin e transportit Brenda territorit të Komunës së Vitisë;
- Bëjmë licensimin e operatorëve për transportin publik urban dhe urbano-periferik dhe vërtetimin e rrezeve të udhëtimit për transportuesit e udhëtarve në territorin e komunës së vitisë;
- Kordinojmë aktivitetin mbi transportin publik të mallrave dhe udhëtarve të kompanive private, taksit individual;
- Bashkëpunojmë dhe kordinojmë punën me PK-në stacioni në Viti, për realizimin e planit të punës.

#### **1.5 Rrugët Lokale**

Komuna i menagjon rruget lokale në bazë të ligjit për Transportin Rrugor.

Drejtoria bashkëpunon me Ministrinë e Infstrukturës në zhvillimin e Komunikacionit.

- Drejtoria do të informoj MI-në për defektet në rrugët regjionale në territorin e sajë.  
Kujdeset për mirmbajtjen e rrugëve lokale në:
  - Renovimin e rrugëve të asfaltuara;
  - Mbushjen e gropave në rrugët me zhavor;
  - Mirëmbajtjen verore dhe dimorore të rrugëve;
  - Pastrimin e rrugëve në qytetin e Vitisë.

#### **1.6 Mirembajtja i objekteve te administrates komunale,shëndetësore dhe arsimore**

Do të bëhet mirëmbajtja dhe pastrimin e objekteve të administrates komunale, shëndetësore dhe arsimore nga kompania e perzgjedhur nga komuna

#### **1.7 Mirembajtja e ndriqimit publik**

Do të bëhet mirëmbajtja e ndriqimit publik në të gjitha fashtrat e Komunës se Vitisë dhe në Qytetin e Vitisë nga kompania e perzgjedhur nga komuna ku paraqiten defektet në ndriqim publik.

### **1.8 Dezinfektimi dhe Dezinsektimi i objekteve të administrates komunale, objekteve Shkollore, shëndetësore dhe Hapsirave Publike**

Do të bëhet Dezinfektimi dhe Dezinsektimi i objekteve të administrates komunale, objekteve Shkollore, shëndetësore dhe Hapsirave Publike nga kompania e perzgjedhur nga komuna ku është e nevojshme te gjitha objektet komunale dhe hapsira publike.

## **2. Sektori i Emergjencave**

- Përgaditja e Planeve të punës është e bazuar në Ligjet në fuqi. (Ligji mbi FNT, Ligji mbi pushtetin lokal, Statuti Komunal dhe të gjitha Ligjet tjera qe janë në fuqi.)
- Puna në VLERSIM TË RREZIKUT, përditimi i të dhënave, afati janar-dhjetor 2021
- Bashkpunimi dhe koordinimi me NJPZSH, PK dhe Drejtorinë për Shëndetësi (Kryqi kuq, Drejtoria për Bujqësi, Kompanit komunale).
- Bashkëpunimi me Struktura Lokale dhe Organizatat dhe Firma private, në përpilimin e planeve për rreziqet dhe reagimin.
- Inplementimi i ligjeve për emergjenca dhe udhëzimeve administrative për menagjimin e emergjencave, zbatimi i tyre dhe krijimi i hapësirave të nevojshme dhe pajisja e tyre me mjete komunikimi (radiolidhje-salla operative).
- Bashkëpunimi dhe raportimi i përditshëm në QRE dhe DME, (kur ka nevoj, ne situata kur ka kërcnime të mundëshme, erëra, stuhi, vërshime, zjarre, ngrica, borë, tërmete).
- Takime me AME, trajnimet Për zyrtar dhe zjarrfiksa).
- Bashkpunimi në kontinuitet me Pjesen rezerv të zjarrfiksave dhe pjesës rezerv për ndihme te parë-angazhimi sezonal.
- Trajnimi i nxënësve nëpër shkolla lidhur me rastet emergjente.
- Bashkpunimi me Udhëheqësit e fshatrave për zvoglimin e dukurive negative-zjarrvënjet;
- Trajnimi i ekipeve vullnetare me Zjarrfikësit, Shtëpinë e Shëndetit.
- Demonstrimi i Evakuimit të personelit në institucione publike (shkolla). (Ushtrim në muajin shtator 2021)
- Përgaditja e Planeve Operacionale.
- Mbledhja e të dhënave nga tereni për të vlersuar rrezikun duke u bazuar në aksidentet potenciale, llojin e aksidenteve dhe pasojat e tyre. (janar-dhjetor 2021)
- Inspektimi dhe pregatitja e raporteve për situatat emergjente (vërshime, tërmete, zjarre, eksplozime, epidemi, etj.).
- Finalizimi i POE.

## **2.1 Njësia profesionale e zjarrfikjes dhe shpëtim:**

- Koordinimi i punëve me Ministrinë e punëve të mbrendshme për përfundimin e projektit për objektin për njësinë e zjarrfikjes dhe shpëtim në Viti;
- Funizim me inventar për objektin e NJPZSH në Viti
- Funizim me lëndë djekëse pellet dhe derivate.

## **2.2 Zyra e Preventives ndaj Zjarrit-Viti**

Aktivitetet e zyrës së preventives ndaj zjarrit do të jenë të përhershme në ndërmarrjen e masave preventive në mënyrë ekspertive dhe kualitative me qëllim të vetëdijësimit të popullatës dhe avancimin e sigurisë ndaj mbrojtjes nga zjarri duke u bazuar në Ligjin e Mbrojtjes nga Zjarri.

Zyra e Preventives ndaj Zjarrit-Viti, bënë këto aktivitete:

- Inspektimin e objekteve shkollor;
- Inspektimin e objekteve Shëndetësore;
- Inspektimi i objekteve komunale;
- Inspektimin e bizneseve private ( objektet tregtare ,sherbyre , sallave për dasme, pompat karburanteve , fabrikave të ujit etj);
- Inspektimin e zjarreve fushore dhe malore.

Viti, me dt.13.01.2021

Drejtori  
Nexhmedin Jakupi

